

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 16 të Rregullores për Regjistrin e Kredive, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 12 shkurt 2020, miratoi këtë:

UDHËZIM PËR REGJISTRIN E KREDIVE

Neni 1 Qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e procedurës për raportimin në Sistemin e Regjistrin të Kredive respektivisht për mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave pozitive dhe negative lidhur me kredite aktive dhe historinë kreditore, të personave fizik dhe juridik, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditor si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të Bankës Qendrore.

2. Sistemi i Regjistrin të Kredive të Kosovës (RKK) është i detyrueshëm për t'u përdorur nga ofruesit e kredive dhe si i tillë monitorohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) si rregullator i industrisë financiare. Struktura ligjore është e përcaktuar në Rregulloren për Regjistrin e Kredive.

Neni 2 Fushëveprimi

Udhëzimi për Regjistrin e Kredive të Kosovës (në tekstin e mëtejme: "RKK") është udhëzim mbi raportimin e të dhënave kreditore në sistemin e RKK-së. Si i tillë është i zbatueshëm për institucionet financiare të përcaktuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: BQK), për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikrofinanciare të licencuara, si dhe ato institucione financiare

jobankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

Neni 3

Termet dhe definicionet

1. Të gjitha termet në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara në Rregulloren për Regjistrin e Kredive dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e këtij udhëzimi:
 - 1.1. "*regjistri i kredive*" nënkupton regjistrin e kredive i cili operon si një sistem i centralizuar për grumbullimin dhe shpërndarjen e informacioneve në mes të ofruesve të kredive.
 - 1.2. "*raportues i të dhënave*" nënkupton entitetin juridik i cili raporton të dhënat në sistemin e regjistrit të kredive. Raportuesit e të dhënave janë: çdo bankë e licencuar, çdo institucion mikrofinanciar e licencuar, çdo institucion financiar jobankar të licencuar për aktivitete të veçanta kreditor ose çdo kompani e sigurimit e licencuar për aktivitete të veçanta kreditor (lëshimi i garancioneve).
 - 1.3. "*garancioni i kontratës*" nënkupton të gjitha garancionet e lëshuara nga kompanitë e sigurimit që për subjekt kanë sigurimin e kontratës dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej saj.
 - 1.4. "*garancioni i tenderit*" nënkupton të gjitha garancionet e lëshuara që për qëllim kanë pjesëmarrjen në Tender (sigurimin e ofertimit).
 - 1.5. "*ekspozim kreditor i ristrukturuar*" nënkupton ekspozimin kreditor të cilit i ndryshohen kushtet kontraktuale për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të klientit, që ndër të tjera përfshin : zgjatjen e maturimit ose konsolidimin e më shumë se një ekspozimi kreditor në një ekspozim të vetëm duke ndryshuar kushtet kontraktuale.
 - 1.6. "*performancë e qëndrueshme*" nënkupton katër pagesa me radhë të kryegjësë dhe të interesit sipas planit të pagesës.
 - 1.7. "*përdorues*" nënkupton punonjësit e autorizuar nga BQK/Institucionet kredidhënëse për të pasur qasje në sistemin e RKK-së.

- 1.8. “fajll” nënkupton të dhënat e organizuara në mënyrë logjike sipas formatit të paracaktuar të cilat mund të pranohen dhe të përpunohen nga aplikacionet kompjuterike .
- 1.9. “ueb shërbime” nënkupton pjese të programeve kompjuterike të cilat mundësojnë komunikimet e të dhënave përmes internetit duke përdorur sisteme të standardizuara të mesazheve.

Neni 4

Raportimi i të dhënave në sistemin e RKK-së

1. Raportimi i të dhënave për kredimarrësit, kreditë, personat e lidhur, dhe kolateralet, në sistemin e RKK-së duhet të bëhet më së largu deri në fund të ditës së ardhshme të punës pas disbursimit të kredisë. Raportimi i të dhënave në sistemin e RKK-së mund të bëhet në tri forma: në formë manuale, përmes fajllave si dhe përmes ueb shërbimeve. Ofruesit e kredive do të vendosin se cilën formë do të përdorin.
2. Në sistemin e RKK-së kompanitë e sigurimit janë të obliguar që t'i regjistrojnë të gjitha llojet e Garancionit të Kontratave, duke përfshirë edhe Garancionin e Tenderit.
3. Ekzistojnë katër fajlla për raportimin e të dhënave në sistemin e regjistrimit të kredive: fajlli i kredive, fajlli i personave të lidhur me kredinë, fajlli i kolateralit dhe fajlli i klasifikimeve.
 - 3.1. Fajlli i kredive përbëhet nga informatat e detajuara mbi ofruesin e kredisë, kreditë dhe kredimarrësit.
 - 3.1.1. Informatat e kërkuara (obligative) mbi ofruesin e kredisë janë: emri i institucionit (ofruesit të kredisë) si dhe dega e ofruesit të kredisë.
 - 3.1.2. Informatat e kërkuara mbi kredimarrësin janë dhe nuk kufizohen në: emri, mbiemri, numri personal, statusi, adresa zyrtare, vendi, komuna, data e lindjes/regjistrimit, vendi i lindjes/regjistrimit.
 - 3.1.3. Informatat e kërkuara mbi kredinë janë dhe nuk kufizohen në: numri identifikues i kredisë, sektori, shuma e aprovuar, shuma e shpërndarë, shuma e mbetur, lloji i periudhës (muaj/vit/ditë), frekuenca e pagesës, shuma e pagesës, valuta, data e aprovimit, data e disbursimit, data e maturimit, përdorimi i kolateralit, vlera e kolateralit, klasifikimi i aseteve.

- 3.2. Fajlli i personave të lidhur përbën informata të detajuara mbi personat fizik apo juridik të ndërlidhur me kredinë sipas rolit të definuar në kontratën e kredisë.
- 3.2.1 Në rastet e entitetit juridik, duhet regjistruar të dhënat personale të pronarit ose personit kontaktues të entitetit juridik.
- 3.2.2. Në rastet e bizneseve individuale/ ortakërive, duhet të regjistrohen të dhënat personale të pronarit/partnerëve dhe personit/personave të autorizuar.
- 3.2.3. Në rast të korporatave duhet të regjistrohen të dhënat personale të aksionarit/aksionarëve të cilët posedojnë një të tretën apo më shumë të aksioneve, si dhe të dhënat personale të personit të autorizuar i cili mund të përfaqësojë korporatën.
- 3.2.4. Në rast të OJQ-ve (organizatave joqeveritare), kërkohet të regjistrohen të dhënat personale të personit/personave të autorizuar që mund të përfaqësojë organizatën. Në të gjitha rastet nëse numri i personave të autorizuar është më i madh se dy, duhet të regjistrohen të dhënat personale të dy personave me pozitat më të larta.
- 3.3. Fajlli i kolateralit përbën informata mbi kolateralet e ndërlidhura me kredi. Llojet e para-definuara të kolateraleve duhet bartur te lloji i kolateralit. Duhet regjistruar gjithashtu numrin serik, vlerën dhe përshkrimin e kolateralit, numrin identifikues të ofruesit të kolateralit dhe informacionin nëse kolaterali është i regjistruar në regjistrin e pengut apo jo.

Neni 5

Përditësimi i të dhënave

1. Institucionet kredidhënëse duhet të përditësojnë statusin e çdo kredie aktive sipas gjendjes së ditës së fundit kalendarike të çdo muaji. Ky përditësim duhet të bëhet më së largu deri më datën pesëmbëdhjetë të muajit të ardhshëm përmes fajllit të klasifikimit. Përditësimi i të dhënave mund të bëhet sipas nevojës edhe më shpesh, mirëpo përditësimi i ndërlidhur me fundin e muajit edhe më tutje duhet performuar.
2. Përveç shumës së mbetur të kredisë duhet raportuar edhe kategoria e klasifikimit të kredisë. Mbetjet e kredive duhet të klasifikohen në minimum në bazë të gjatësisë së vonesave. Ekzistojnë pesë kategori të klasifikimeve të mbetjeve të kredive: kreditë standarde (A) me performancë normale të cilat mund të kenë deri në 30 ditë vonesë; kreditë monitoruese (B)

në vonesë 31-60 ditë; kreditë nën standarde (C) në vonesë 61-90 ditë; kreditë e dyshimta (D) në vonesë 91-180 ditë; kreditë e humbura (E) në vonesë më shumë se 180 ditë.

3. Ekspozimi kreditor i ristrukturuar duhet të klasifikohet të paktën në kategorinë nën standard (C) apo më keq dhe duhet të vazhdojë të klasifikohet në kategorinë e njëjtë deri sa të vërehet një performancë e qëndrueshme. Pas përfundimit të çdo periudhe të performancës së qëndrueshme, banka mund të klasifikojë ekspozimin kreditor të ristrukturuar për një kategori më të mirë.
4. Institucionet kredidhënëse duhet të përditësojnë kreditë të cilat konsiderohen si joaktive por që edhe më tutje kanë një shumë mbetje të papërfunduar. Kreditë të cilat janë kategorizuar si të shlyera “written off” duhet raportuar duke reflektuar saktësisht shumën e mbetur të kredisë. Kreditë të cilat mbyllen me klasifikimin L (Likuiduar) dhe W (“Writte off”) me shumën e mbetur zero (0.00), duhet të raportohen në sistemin e RKK-së brenda 24 orëve nga data e shlyerjes së borxhit. Kreditë e raportuara njëherë si të likuiduara apo të shlyera, nuk mund të raportohen më me status tjetër.
5. Klasifikimi i garancioneve nga kompanitë e sigurimeve duhet të bëhet si në vijim:

5.1 Klasifikimi - Standard (A), klasifikohen produktet e veçanta kreditore - garancionet të cilat janë brenda afatit për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në mes të siguruarit dhe autoritetit kontraktues. Gjatë raportimit të klasifikimit tek shuma e mbetur dhe shuma e disbursimit, të dhëna të cilat kërkohen në fajllin për klasifikim, vendoset shuma e siguruar e garancionit bazuar në policën e sigurimit.

5.2 Klasifikimi – Jostandard/Humbje (E), klasifikohen produktet e veçanta kreditore- garancionet të cilat nuk përmbushin detyrimet kontraktuale brenda afatit të caktuar, dhe autoriteti kontraktues merr dëmshpërblimin për shumën e siguruar nga kompania e sigurimit. Deri në momentin që kompania e sigurimit nuk rimbursion nga i siguruari shpenzimet e mbuluara, raportimi do të vazhdojë me klasifikimin E, ndërsa në momentin e rimbursimit të shumës së siguruar, atëherë produkti klasifikohet si i Likuiduar (L).

5.3 Klasifikimi - Write Off (W), raportohen produktet e veçanta kreditore (garancionet) për të cilat kompania e sigurimit nuk mund të rimbursojë shumën nga i siguruari dhe vendos për shlyerjen e shpenzimeve të mbuluara. Raportimi i klasifikimit W nuk ka nevojë të përsëritet në baza mujore vetëm me rastin e ndryshimit të shumës së mbetur apo të rimbursimit të shumës nga i siguruari, atëherë klasifikimi raportohet me W por shuma e mbetur 0.00.

5.4 Klasifikimi – Likuiduar (L), raportohen produktet e veçanta kreditore-garancionet të cilat përmbushin detyrimet kontraktuale.

Neni 6
Kualiteti i të dhënave

Raportuesit e të dhënave në sistemin e RKK-së mbajnë përgjegjësi mbi saktësinë dhe kualitetin e të dhënave.

Neni 7
Informacionet e paraqitura në raportin kreditor

1. Regjistri i kredive mund të shpalojë informacionet që identifikojnë personin fizik duke përfshirë dhe jo kufizuar në :
 - 1.1 Data e regjistrimit të informatës
 - 1.2 Emri dhe mbiemri
 - 1.3 Adresa aktuale
 - 1.4 Numri personal
 - 1.5 Numri i pasaportës
 - 1.6 Vendi dhe data e lindjes
 - 1.7 Profesionin.

2. Regjistri i kredive mund të shpalojë informacionet që identifikojnë entitetin juridik duke përfshirë dhe jo kufizuar në :
 - 2.1 Datën e regjistrimit të informacionit
 - 2.2 Emrin e biznesit apo kompanisë
 - 2.3 Numrin Unik Identifikues të biznesit
 - 2.4 Datën e themelimit
 - 2.5 Adresën e regjistrimit të biznesit

Neni 8
Menaxhimi i qasjes së përdoruesve

1. Divizioni i Regjistrimit të Kredive menaxhon dhe administron sistemin e RKK-së si dhe qasjet e institucioneve, gjegjësisht përdoruesve të tyre.
2. Qasja në sistemin e RKK-së bëhet pasi që të jenë përmbushur kriteret e kërkuara nga BQK, në veqanti autorizimin për qasje në sistemin e RKK-së, e cila ndërlihet me sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave nga qasjet e paautorizuara.

3. Vetëm përdoruesit e autorizuar nga institucionet kredidhënëse apo përdoruesit me autorizim nga BQK-ja mund t'i qasen sistemit të RKK-së. Autorizimet nga institucionet duhet konfirmuar përmes formave të aprovuara nga regjistri i kredive dhe janë obligative për t'u përcjellë në BQK.
4. Për përdoruesit e institucioneve kredidhënëse janë dy nivele të qasjes në sistemin e regjistrit të kredive:
 - 4.1. Niveli i parë mundëson hulumtimin e informacioneve për aplikantët kreditorë/kredimarrësit.
 - 4.2. Niveli i dytë mundëson hulumtimin, raportimin, azhurnimin dhe modifikimin/(korrigjimin) e të dhënave të raportuara në Sistemin e RKK-së.
5. Institucionet kredidhënëse përcaktojnë nivelet e të drejtave për përdoruesit e tyre dhe lidhur me këtë njoftojnë regjistrin e kredive. Bazuar në këto njoftime, regjistri i kredive bënë ndarjen e të drejtave për qasje në sistem.
6. Regjistri i kredive kërkon që të bëhet njoftimi nga institucionet kredidhënëse lidhur me ndërprerjen e autorizimit të përdoruesve për çfarëdo arsye (p.sh. lëvizja në pozita tjera apo ndërprerja e marrëdhënies së punës). Njoftimi duhet të bëhet së paku 7 ditë pune para përfundimit të autorizimit të qasjes së përdoruesit.

Neni 9

Siguria e të dhënave

1. Regjistri i kredive do të ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar implementimin dhe zbatimin e të gjitha rregullave dhe procedurave të aprovuara nga BQK-ja, që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave nga qasjet, zbulimet apo modifikimet e paautorizuara.
2. Për të realizuar me sukses këtë objektiv, duhet të funksionojë një nivel i lartë i besueshmërisë në mes të sistemit të RKK-së, përdoruesve të tij dhe subjekteve të të dhënave. Përdoruesit e sistemit të RKK-së duhet të sigurohen, që informacionet e regjistruara në sistem mbi kredimarrësit nuk do të keqpërdoren.
3. Subjektet e të dhënave duhet të sigurohen se mbrohet privatësia e tyre dhe se informacionet e tyre, do të përdoren nga përdoruesit e sistemit të RKK-së në mënyrë të përgjegjshme.

4. Regjistri i kredive dhe përdoruesit e sistemit të RKK-së duhet të sigurohen mbi transparencën e operacioneve duke mbrojtur konfidencialitetin e informacioneve të regjistruara në sistemin e RKK-së.
5. Departamenti i Teknologjisë Informative të BQK-së është përgjegjës për mirëmbajtjen e politikave të sigurisë. Masat e duhura të sigurisë minimizojnë rrezikun dhe mundësojnë aritjen e niveleve më të larta të standardeve të sigurisë.

Neni 10 Përgjegjësitë e përdoruesve

1. Në çdo të dhënë të marrë nga sistemi i RKK-së mbi subjektet e të dhënave, përdoruesit e sistemit të RKK-së duhet të trajtojnë këto të dhëna me përgjegjësi dhe të aplikojnë politikën e konfidencialitetit.
2. Përdoruesit duhet të definojnë masat e përshtatshme të sigurisë për të parandaluar:
 - 2.1. Qasjet e paautorizuara në të dhënat personale, ndërrimin e tyre, shkatërrimin apo humbjen;
 - 2.2. Transferimin e paautorizuar të të dhënave të sistemit të RKK-së;
 - 2.3. Procesimin dhe keqpërdorimin e të dhënave personale;

Neni 11 Shkëmbimi i informacionit të kredive me vendet e huaja

Regjistri i kredive, informatat personale të cilat i ka në pronësi apo nën kontroll, nuk do të transferojë te ndonjë organizatë jashtë Kosovës përveç ashtu siç parashihet me Rregulloren për Regjistrin e Kredive.

Neni 12 Konsultimi i RKK-së

1. Ofruesit e kredive mund të marrin raportin kreditor nga RKK-ja për çdo klient (aplikant kreditor/kredimarrës) vetëm pasi të kenë siguruar pëlqimin nga subjekti i të dhënave për t'iu qasur raportit kreditor të klientit.
2. Ofruesit e kredive do të kenë qasje në:
 - 2.1. Informacione të përgjithshme personale mbi klientin;

- 2.2. Kreditë personale të klientit; Ekspozimin total përfshirë edhe kreditë e ndërlidhura; Lloji i kredisë dhe numri i tyre; Të dhënat mbi kategorinë e çdo klasifikimi për çdo kredi përfshirë valutën, shumën e aprovuar, disbursuar dhe shumën e mbetur.
 - 2.3. Rolet e ndërlidhura kreditore të klientit: Klienti mund t'i ketë pesë role të ndryshme në lidhje me kreditë të cilat nuk janë kredi personale. Ai/Ajo mund të jetë pronar/partner/aksionar i organizatës biznesore ose person i autorizuar i organizatës e cila ka kredi. Klienti mund të jetë garantues/bashkëkredimarrës në raport me ndonjë kredi. Të gjitha këto kredi do të paraqiten në raportin e agreguar kreditor në bazë të roleve të klientit dhe kategorisë së klasifikimit të kredisë.
 - 2.4. Kolaterale të shfrytëzuara nga klienti: Klienti mund të shfrytëzojë kolaterale në lidhje me kreditë e tij/saj personale ose të kredive tjera. Të gjitha kolaterale të shfrytëzuara paraqiten në raport kreditor. Të dhënat e paraqitura mbi kolaterale përbëhen nga numri i regjistrimit të kolateralit, vlera e kolateralit e vlerësuar në euro, si dhe përshkrimi i kolateralit.
3. Identiteti i ofruesve të kredive nuk do të shpaloset në raportin kreditor.

Neni 13

Mbrojtja e të dhënave dhe kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave

Të gjitha të dhënat janë të mbrojtura në bazë të principeve të mbrojtjes së të dhënave. Privatësia e çdo individ është e garantuar. Të dhënat kreditore do të mbahen deri në pesë (5) vite pas përditësimit të fundit me shumën e mbetur zero. Kreditë e klasifikuara në kategorinë W do të paraqiten deri në shtatë (7) vite pas përditësimit të fundit me shumën e mbetur zero. Pas kësaj periudhe të dhënat do të arkivohen.

Neni 14

Roli i BQK-së

1. BQK-ja administron dhe mirëmban sistemin e RKK-së. Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare si dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve do të kenë qasje të plotë në të dhënat e sistemit të RKK-së. Këto të dhëna kreditore/raporte do të verifikohen me librat përkatës të ofruesve të kredive. Për qëllime analitike dhe statistikore në të dhënat e sistemit të RKK-së, mund të ketë qasje edhe Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Analizave Ekonomike, Departamenti i Statistikës, Licencimit dhe departamentet tjera

relevante që ndërliiden funksionet e tyre me informacionet që gjeneron Sistemi i RKK-së.

2. BQK-ja mund të sigurojë raportin kreditor të kredimarrësit ose të ofruesit të kredive, tek palët e treta nëse kërkohet me ligj apo me urdhër të gjykatës.

Neni 15

Marrja e pëlqimit nga subjekti i të dhënave

1. Ofruesit e kredive duhet të marrin pëlqimin nga subjekti i të dhënave në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Përmes pëlqimit të subjektit të të dhënave, ofruesi i kredive autorizohet të bëjë hulumtimin, përpunimin dhe raportimin e informacionit dhe të dhënave të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.
2. Ofruesit e kredive duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë marrjen e pëlqimit nga subjekti i të dhënave sipas paragrafit 1 të nenit 15 të kësaj rregulloreje.
3. Përpunimi i të dhënave personale do të bëhet në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Ofruesit e kredive duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që subjektet e të dhënave e kuptojnë efektin e dhënies së pëlqimit .
5. Ofruesit e kredive nuk duhet të ndërmarrin veprime që në mënyrë të vetëdijshme t'ia fshehin subjektit të të dhënave kuptimin e pëlqimit ose kërkesën për pëlqim.
6. Pëlqimi i subjektit të të dhënave do të jetë i vlefshëm për gjithë kohën e vlefshmërisë së marrëveshjes së kredisë, përfshirë marrëveshjen e ripërtërirë apo ndryshimin e kushteve të marrëveshjes ekzistuese.

Neni 16

Tarifa dhe faturimi

1. Raportimi i të dhënave kreditore në sistemin e RKK-së është obligativ dhe gjatë këtij procesi nuk aplikohet ndonjë tarifë. Hulumtimi i informacioneve në sistemin e RKK-së tarifohet duke u bazuar me tarifat e aprovuara nga BQK-ja.
2. Tarifat do të kalkuloohen në baza mujore për bankat dhe institucionet mikrofinanciare të licencuara, si dhe ato institucione financiare jobankare dhe kompani të sigurimeve të

licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore. Institucionet bankare kanë llogari në BQK dhe pas njoftimit të detajuar mbi kalkulimin mujor të tarifave në bazë të hulumtimeve të bëra, këto llogari debitoohen në mënyrë automatike. Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet tjera jobankare financiare, janë të obliguara që faturat e pranuar nga BQK-ja t'i paguajnë më së largu deri më datën 15 të muajit aktual për hulumtimet e bëra në muajin paraprak. Të gjitha institucioneve do t'u përcillet ekstrakti mujor mbi shumën totale dhe numrin e hulumtimeve të bëra nga përdoruesit e tyre.


3. Tarifat mund të rishikohen nga BQK-ja . Ndryshimet në tarifa do të publikohen jo më vonë se një muaj para vlefshmërisë së tyre.

Neni 17
Ndëshkimet

Shkeljet e këtij udhëzimi do të jenë subjekt i ndëshkimeve ashtu siç parashihet me Rregulloren e Regjistrit të Kredive.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 1 mars 2020 dhe me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet Udhëzimi për Regjistrin e Kredive i miratuar nga Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 30 prill 2018.



Fehmi Mehmeti
Kryesues i Bordit Ekzekutiv